



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË

Korçë, më 13/12/2016

RAPORT I MBAJTUR NË TAKIMIN E BUXHETIMIT ME PJESËMARRJE ME BANORËT  
NJËSISË ADMINISTRATIVE MOLLAJ

Morën pjesë: Kryetari i Bashkisë Sotiraq Filo, staf i bashkisë, banorë të njësisë administrative Mollaj dhe organizata të tjera .

Në vijim të procesit të përgatitjes së projektbuxhetit për vitin 2017 takuam banorët e Njësisë Administrative Mollaj në datë 13/12/2016 për të vendosur së bashku prioritetet e investimeve me qëllim përmirësimin e jetesës në çdo fshat ku ata jetojnë. Një diskutim i cili u mbështet tek punët dhe investimet e kryera gjatë kësaj kohe si dhe kërkesat e nevojat e tyre prioritare në lidhje me vazhdimësinë e punës për pastrimin dhe sistemimin e kanaleve ujitës dhe kullues në parcelat bujqësore, përmirësimin e sistemit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve të ujërave të zeza, sistemimi i rrugëve hyrëse dhe shesheve në fshatra.





